



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.28/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Qendra Tregtare E..., me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim avokat Nazmije Ibrahim, kundër të paditurve B.P., të cilin e përfaqëson me autorizim Burim Islami përmes zyrës së avokatisë “B&B” Sh.p.k, me seli në Gjilan dhe Kompania e Sigurimeve S..., me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson M.B., duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.10/18, i datës 10.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 13.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET ankesa e paditësit Qendra Tregtare E..., me seli në Ferizaj, dhe ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.10/18 i datës 10.12.2019, dhe çështja i kthehet Departamentit për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A R S Y E T I M

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.10/118, i datës 10.12.2019 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Qendra Tregtare “E...”, me seli në Ferizaj, kundër të paditurve B.P.nga fshati Komuna e Vitisë dhe Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit material në emër të dëmit material, si pasoje e aksidentit të datës 30.07.2018. ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është obliguar paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të paditurit B.P.t’ia kompensoje në shumën prej 239,00€ në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, në të kundërtën do të urdhërohet procedura përmbartimore. Ndërsa në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesës së të paditurit për shpenzimet e procedurës dhe atë për shumën prej 270,00€ si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi Qendra Tregtare E..., me seli në Ferizaj, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e

paditësit të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.10/18, i datës 10.12.2019 të ndryshohet ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit, ose aktgjykimin ta prishë dhe çështjen t’ia kthej në rigjykim shkallës së parë.

Përgjigje ne ankesë nuk ka.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Qendra Tregtare “E...”, me seli në Ferizaj, me datën 05.01.2018 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë kundër të paditurit B.P. nga fshati Komuna e Vitisë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e tij, ashtu që të detyrohet i paditurit B.P. që paditësin ta kompensoje në shumën prej 1,687.40€, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës. Paditësi përmes të autorizuares së saj me parashtrësën e datës 11.09.2019 ka bërë zgjerimin e padisë edhe ndaj të paditurën Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë. Ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesën padinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e ankimuar C.nr.10/18, i datës 10.12.2019, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit B.P. nga fshati Komuna e Vitisë dhe Kompania e Sigurimeve S..., me seli në Prishtinë, që t’ia paguaj kompensimin e dëmit material si pasojë e aksidentit të datës 30.07.2018, dhe ka obliguar paditësin që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të paditurit t’ia kompensoj shumën prej 239.00€. Prandaj, mbi këtë bazë duke u bazuar ne nenin 322.1 dhe 452.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, sipas detyrës zyrtare ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika (f) e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë ose gjykata e llojit tjetër.

Dhoma e Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare dhe duke i’u referuar nenit 19 të LPK-së gjeti se secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdesët për kompetencën e vet lëndore, ndërsa në rastin konkret gjeti se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 17.1 të LPK-së ku thuhet se “ *Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e*

çështjes që i është paraqitur” dhe nenit 29 të LPK-së ku thuhet se “në procedurë kontestimore gjykatat gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vet lëndore të caktuar me ligj”.

Po ashtu duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat me Nr. 06/L – 054, *ka rezultuar se paditësi nuk ka mundur të jetë palë në procedurë për këtë rast në këtë Departament të kësaj Gjykate, sepse paditësi e ka pasur statusin e shoqërisë tregtare SHPK.*

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë fillimisht është dashtë ta vlerësojë kompetencën e vet lëndore në këtë çështje juridike. Neni 13 pika 1, nen pika 1.1 LIGJI (NR.08/L-015) për Gjykatën Komerciale përcakton se “*kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre*”.

Dhoma e Shkallës së Dytë, sipas detyrës zyrtare gjeti se me nenin 13 par 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar kompetenca lëndore e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë dhe Dhoma e Shkallës së Dytë si vijon: “*Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre*”.

Me aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas kërkesës, duke mos pasur kompetencë lëndore për zgjedhjen e kësaj çështje juridike dhe në këtë rast ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 182 paragrafi 1 pika (f) me të cilën është paraparë se “*në çoftëse gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtte, gjykata e llojit tjetër*”.

Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë është kujdesur sipas detyrës zyrtare, e që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i ankimuar doemos është dashur të prishet dhe të kthehet në Departamentin për çështje ekonomike të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, për rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.28/22 datë 13.10.2022

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Krenar Berisha